



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Produkt Received/Delivered	15.06.2021	viti god year	
Organ /Rjeshta Organ /Jedinita Org /Unit	Nr Prot Pr Prot Prot No	Shtesa Punëj Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SCMBAIK	3089/2021		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.289/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.289/2021 të datës 20.04.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë rr. "Shaban Polluzha",nr.223, Komuna e Drenasit, kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 15.06.2021, mori këtë:

### V E N D I M

**I.REFUZOHET** si e pabazuar ankesa me numër A.nr.21/2021 e datës 20.01.2021, e parashtruar nga ankuesi

**II. MBETET ne fuqi** Vendimi me numër Nr.01/2021 i datës 23.03.2021, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

### A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, sipas Akt Emërimit të datës 04.10.2016 në pozitën "Administrator i lartë i Ti-së për rrjetin mikrovalor", me datën 24.11.2020, Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë ka iniciuar procedurë disiplinore. Komisioni Disiplinor me datën 22.12.2020, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 521/2020, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "I ndalohet 40 % e pagës për periudhën kohore deri në gjashtë muaj".

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokolli 521/2020 të datës 22.12.2020, brenda afatit ligjor komfor nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit

Civil të Kosovës, me datën 20.01.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 230/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, më datën 27.01.2021 kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit e ka proceduar tek Ministria e Punëve të Brendshme. Me datën 03.02.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Me datën 15.03.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerr vendimin me numër A.nr.21/2021, me të cilin ka detyruar Komisionin Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që ta rishqyrtoj procedurën disiplinore, ndaj ankuesit, i cili me datën 23.03.2021, ka nxjerr vendimin me numër të protokollit Nr.01/2021 me të cilin ankuesit, i ka shqiptuar prapë masën disiplinore "I ndalohet 40% e pagës për periudhën kohore gjashtë (6) mujore", pas pranimit të vendimit nga ana e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër të protokollit Nr.01/2021, të datës 23.03.2021, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datën 20.04.2021, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1898/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar masën e shqiptuar nga ana e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme."

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 230/2021 të datës 20.01.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i datës 22.12.2020 me numër Nr.521/2020 i Komisionit disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimi me numër A.nr.384/2019 i datës 07.12.2020 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër Nr.3/2018 i datës 01.08.2019 i Komisionit disiplinor të Ministrisë së Administratës Publike; Shkresë zyrtare e datës 15.06.2016 nga ankuesi për Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit; E-maili zyrtar i datës 18.08.2016; E-maili zyrtar i datës 16.07.2016; E-maili zyrtar i datës 15.07.2016; E-mailat zyrtar të datës 14.01.2021; E-maili zyrtar i datës 16.12.2020; E-maili zyrtar i datës 15.12.2020; Shkresë zyrtare nga Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti i financave për muajin tetor 2020; E-maili zyrtar i datës 03.04.2019; E-maili zyrtar i datës 05.04.2019; E-mailat zyrtar të datës 04.04.2019; E-mailat zyrtar të datës 22.03.2019; E-maili zyrtar i datës 13.03.2019; E-maili zyrtar i datës 26.02.2019; E-mailat zyrtar të datës 30.09.2014; E-maili zyrtar i datës 05.11.2019; E-maili zyrtar i datës 04.11.2019; Kërkesë e datës 05.11.2019; E-maili zyrtar i datës 04.11.2019; Kërkesë e datës 05.11.2019 dhe 12.11.2019; E-maili zyrtar i datës 06.11.2019; E-maili zyrtar i datës 30.10.2019; E-maili zyrtar i datës 09.06.2020; E-maili zyrtar i datës 08.06.2020; Kërkesë e datës 08.06.2020, 10.06.2020; E-maili zyrtar i datës 12.08.2020; E-maili zyrtar i datës 10.08.2020; E-mailat zyrtar të datës 07.08.2020; E-mailat zyrtar të datës 19.01.2021; E-maili zyrtar i datës 14.07.2020; E-maili zyrtar i datës 10.07.2020; E-mailat zyrtar të datës 19.01.2021; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës; Përgjigja në ankesë e datës 03.02.2021; Akt emërim i ankuesit i datës 03.10.2016 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës; Kërkesë për inicimin e procedurave për komision disiplinor e datës 25.11.2020; Procesverbal i Komisionit Disiplinor i datës 21.12.2020; Ftesë për seancë disiplinore e datës 25.11.2020; E-maili zyrtar i datës 26.11.2020; E-maili zyrtar i

datës 25.11.2020; Vendim i datës 30.11.2020 për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit disiplinor; E-maili zyrtar i datës 26.11.2020; E-maili zyrtar i datës 25.11.2020; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2018 për ankuesin; Formulari për vlerësimin e punës për vitin 2019 për ankuesin; Kërkesë për shërbim të vozitjes e datës; Vendimi me numër të protokollit Nr.01/2021 i datës 23.03.2021, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Ankesa e ankuesit me numër të protokollit 1898/2021, e datës 20.04.2021, e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër VK.nr.25/2021 i datës 02.06.2021 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës me numër A.nr.289/2021 të datës 20.04.2021, nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke u bazuar në këto rrethana, dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e pa bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor, i Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka nxjerrë Vendimin me numër të protokollit Nr.01/2021 të datës 23.03.2021, sipas të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore ***"i ndalohet 40% e pagës për periudhën kohore deri në gjashtë (6) muaj"***, edhe pas vendimit me numër A.nr.21/2021 të datës 20.01.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me të cilin ka detyruar Komisionin Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, që ta rishqyrtoj procedurën disiplinore ndaj ankuesit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar vendimin me nr.01/2021 të datës 23.03.2021, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka konstatuar se: Komisioni disiplinor ka vepruar në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse me rastin e shqiptimit të masës disiplinore: ***"i ndalohet 40% e pagës për periudhën kohore deri në gjashtë (6) muaj"***, ka marrë për bazë të gjitha faktet dhe provat që kanë shpjer deri tek ky vendim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të lëndës dhe fakteve të prezantuara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se: duke marrë parasysh se ankuesi edhe në të kaluarën me vendim të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ka qenë i sanksionuar për shkak të sjelljeve jo të mira me udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë dhe ka marrë vërejtje, si nga Drejtoresha e Drejtoratit për Rrjeta dhe Telekomunikime në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit, poashtu edhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Informacionit për gjuhë të ulët komunikimi dhe shkelje të kodit të etikës ndaj udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë edhe masa disiplinore ***"i ndalohet 40% e pagës për periudhën kohore deri në gjashtë (6) muaj"***, e shqiptuar nga ana e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është masë e shqiptuar në proporcion me shkeljen e kryer nga ankuesi në pajtim me nenin 45, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L - 114, për Zyrtarët Publik të Republikës së Kosovës, në të cilin decidivisht thuhet se: ***"1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatimi jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"***, e që në rastin ankuesi me vetëdije ka kryer shkeljet e theksuara si: mos kryerjen e detyrave të tij të dhëna nga ana e udhëheqësit të tij të

drejtpërdrejtë, rast ky i datës 07.08.2020, përmes e-mailit zyrtar, ku Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit disa herë radhazi kërkon nga ana e vartësve të tij ne këtë rast edhe ankuesit që theksohet se: *“ problemet ne QRA/QPD Rahovec, te evitohen për shkak se ka 3 ditë që ky institucion është jashtë rrjetit qeveritar, pas testimave të bëra nga administratorët e rrjetit është konstatuar se është dëmtuar kabulli STP”*, ndërsa ankuesi përmes e-mailit te datës 07.08.2020, udhëheqësit të tij të drejtpërdrejtë i drejtohet ne këtë mënyrë: *“zotëri zyrtar je kahi e tregon paaftësinë tënde apo ke ndonjë qellim tjetër apo edhe je i nxitur”*, sjellje kjo qe hynë në kategorinë e shkeljeve të rënda ne shërbimin civil e në kundërshtim me nenin 46 paragrafin 3 nën paragrafin 3.6. te Ligjit Nr. 06/L - 114, për Zyrtaret Publik të Republikës së Kosovës , në të cilin thuhet se : *“ 3.6.shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil”*. Po ashtu në lidhje me vërtetësinë e provave, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar dhe analizuar situatën e mos bashkëpunimit të ankuesit me udhëheqësin e tij të drejtpërdrejtë, deri në masën edhe të refuzimit të detyrave të punës të dhëna nga ana e udhëheqësit të tij dhe ka konstatuar se: udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit përmes e-mailit të datë 02.11.2020, ka kërkuar nga vartësit e tij, në rastin konkret edhe të ankuesit që *“ te plotësohen kërkesat për shërbim te vozitjes për muajin tetor 2020, te nënshkruhen dhe t’i sjellin tek unë sot gjatë ditës”*, mirëpo që ankuesi gjate seancës se mbajtur me datën 21.12.2020 , i pyetur nga Komisioni Disiplinor, i Ministrisë se Punëve te Brendshme, lidhur me këtë çështje, ka deklaruar se *“unë çdoherë i plotësoj këta formular, por nuk i dorëzoj direkt te Udhëheqësi i Sektorit për shkak se i njëjti nuk mban maske kundër virusit covid -19, por ia kam dhënë kolegut pasi kolegu im i zyrës është i ulur ne tavoline me afër udhëheqësi për t’ia përcjellë atij”*, e që në rastin konkret ankuesi ka bërë shkelje të detyrave të , punës, sjellje këto qe bien ndesh me dispozitat e nenit 46 paragrafin 3 nën paragrafin 3.1. të Ligjit Nr. 06/L - 114, për Zyrtaret Publik të Republikës së Kosovës , në të cilin thuhet se: *“3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës”*.


Duke u bazuar në të lartcekurat, dhe duke marrë parasysh të gjitha veprimet që ankuesi ka bërë ,Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të detyrave të punës të përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe aktet nënligjore për zbatimin e tij në fushën e disiplinës, për më tepër zyrtari publik në rastin konkret ankuesi nuk i është përmbajtur detyrimit për respektimin e ligjit, siç parashihet me nenin 25 paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminin, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike”*, po ashtu zyrtari publik ka detyrimin të veprojë në përputhje me urdhrat e marrë nga mbikëqyrësit e tij, sipas ligjit dhe rregullave të brendshme të institucionit”, siç parashihet me nenin 26 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ndërsa sipas nenit 28 të këtij ligji, *zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij”*.

Në bazë të të lartcekurave, meqenëse ankuesi ka bërë shkelje të rëndë disiplinore, udhëheqësi i drejtpërdrejtë i saj, në mënyrë të drejtë ka konstatuar shkeljen e bërë nga ankuesi, në këtë rast ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse ka konstatuar saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore si: *ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;*

kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore "" i ndalohej 40% e pagës për periudhën kohore deri në gjashtë (6) muaj "", e shqiptuar ndaj ankuesit, është në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, sepse është shqiptuar në raport të drejtë me shkeljen e kryer, rrjedhimisht udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ka vepruar në pajtim me nenin 48 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil", nenin 13 paragrafin 4 nën paragrafët 41.dhe 4.2 dhe paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, po ashtu duke marrë parasysh që ndaj ankuesit përmes e-mailit gjatë vitit 2020 respektivisht me datën 12.08.2020, i është shqiptuar vërejtje nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit dhe Vendimi me numër Nr.03/2019 i datës 01.08.2019, ku ndaj te njëjtit Komisioni Disiplinor, i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datën 01.08.2019, ka nxjerre vendimin me numër Nr.03/2019, sipas te cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore: "1/3 e pagës per periudhën kohore prej 1 muaji".

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër A.nr.289/2021**

Ardita PERÇUKU-SHYTI  
  
Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI  
  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

